# EFFORT - PËRMIRËSIMI I OBJEKTEVE PËR NJË TË ARDHME ME NJË TRAJEKTORE OPTIMALE TË BURIMEVE DHE EFIKASITETIT TË ENERGJISË

Autoriteti Kontraktor: **Komisioni Europian**
Programi: **Programi ndërkufitar Shqipëri – Kosovë, Asistenca e Para-Aderimit (IPA II)**
Përfituesit: **Bashkia Mirditë, Albania, Komuna Mirditë Junik, Kosovë, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit**
Kohëzgjatja: **18 Dhjetor 2023 - 18 Dhjetor 2026**

---

## Objektivi i përgjithshëm i projektit

Përmirësimi i efiçencës energjetike të ndërtesave publike në dy bashkitë dhe zvogëlimi i ndjeshëm i konsumit të energjisë, duke instaluar pajisje inovative dhe duke promovuar më tej praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të ndërtesave. Projekti synon gjithashtu të lehtësojë shkëmbimin e njohurive dhe bashkëpunimin ndërmjet dy bashkive, duke promovuar bashkëpunimin ndërkufitar dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në lidhje me efiçencën e energjisë.

Projekti do të fokusohet në ndërtesat publike dhe do të përfshijë zbatimin e masave të tilla si auditimi i energjisë, përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe shtrirja e veprimeve të tij drejt rinovimit të ndërtesave me efikasitet energjetik. Për të siguruar qëndrueshmëri të projekti do të fokusohet në ndërtimin, rritjen dhe përmirësimin e praktikave të qëndrueshme të energjisë në nivel institucional (rajonal dhe lokal), nivel komuniteti dhe midis territoreve ndërkufitare.



---

## Logjika e ndërhyrjes

1. **Ndërhyrjet fizike dhe blerjet e pajisjeve,** duke nënkuptuar blerjen dhe zbatimin/instalimin e paneleve fotovoltaike në ndërtesat publike të specifikuara në të dyja bashkitë, duke përfshirë këtu të gjithë infrastrukturën e nevojshme mbështetëse. Në dy objekte publike parashikohet edhe termoizolimi i fasadës së një godine dhe vendosja e një sistemi të ngrohjes qendrore.

2. **Ndërhyrje teorike/strategjike**, synon adresimin e problemit në burim dhe nënkupton ndërmarrjen e të gjithë trajnimeve, ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve bashkëpunuese ndërmjet të gjithë aktorëve të identifikuar. Nga ana tjetër, projekti parashikon hartimin e Planeve të Efiçiencës së Energjisë për secilën nga bashkitë, të cilat do të ofrojnë një plan të drejtpërdrejtë veprimi që do të zbatohet nga bashkia në afat të gjatë, si dhe krijimin e bazës së të dhënave për masat e EE.

---

Funded by the European Union

EFFORT

## Objektivat specifik

1. Identifikimi i mundësive për përmirësime të efiçiencës energjetike të ndërtesave publike në bashkitë e Mirditës dhe Junikut përmes aktiviteteve të vlerësimit dhe auditimit të energjisë.

2. Ulja e nivelit të konsumit të energjisë dhe emetimit të gazeve serrë nëpërmjet zbatimit/instalimit të teknologjive inovative në ndërtesat publike të të dy bashkive.

3. Rritja e kapaciteteve të stafit bashkiak për masat e efiçencës së energjisë përmes hartimit të një programi trajnimi gjithëpërfshirës dhe ngritjes së kapaciteteve që nxit dhe lehtëson shkëmbimin e njohurive dhe bashkëpunimin ndërkufitarë.

4. Rritja e ndërgjegjësimit publik për përfitimet e efiçencës së energjisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ndërtesave përmes aktiviteteve informuese dhe edukative dhe shkëmbimit ndërkufitar të praktikave më të mira.

## Rezultatet e pritshme

1. Vlerësimi dhe auditimi energjetik i 10 objekteve publike në Bashkinë Mirditë dhe Komunën Junik.

2. Hartimi i Planeve Lokale të Efiçiencës së Energjisë (përfshirë masat strategjike për reduktimin/kursimin e energjisë) që do të zbatohen në një periudhë afatshkurtër në nivel vendor.

3. Hartimi i projekteve teknike për instalimin e pajisjeve inovative (panele fotovoltaike, sistem ngrohje qendrore dhe termoizolim).

4. Instalimi i pajisjeve inovative të kursimit të energjisë deri në vitin e tretë të projektit (panele fotovoltaike në 10 ndërtesa publike), duke përfshirë pilotimin e instalimit të sistemit të ngrohjes termike në një ndërtesë në Junik dhe izolimin termik në një ndërtesë në Mirditë.

5. Ngritja e kapaciteteve në drejtim të përmirësimit të praktikave të efiçencës së energjisë, identifikimit të mundësive të kursimit të energjisë dhe menaxhimit efektiv të pajisjeve nëpërmjet një programi trajnimi gjithëpërfshirës që kontribuon në një funksionim më të qëndrueshëm dhe me kosto efektive të objekteve publike

6. Informimi i komunitetit lokal dhe kryesisht studentëve dhe grupeve të interesit në të dyja njësitë për praktikat e efiçencës së energjisë nëpërmjet aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe iniciativave edukative të realizuara nga projekti.

Funded by the European Union

EFFORT

## Grupet e synuara

Njesitë e Qeverisjes Vendore/Stafi i bashkisë Mirditë dhe Komunës Junik

Institucionet e formimit profesional dhe personeli/ studentët e shkollave në të dyja bashkitë

Agjencitë kombëtare të energjisë/Rregullatorët e energjisë

Komunitetet lokale në Mirditë dhe Junik

## Përfituesit përfundimtarë

20 nxënës nga institucionet e formimit profesional/shkolla të mesme

Komunitetet lokale në Mirditë dhe Junik

Stafi i bashkive Mirditë dhe Junik

## Objektivat e projektit

**– 70 %**
Fatura e energjisë elektrike e ndërtesave publike në bashkitë ndërkufitare

**– 60 %**
Reduktimi i emetimit të gazrave (në ndërtesa publike që përdorin biomasë për ngrohje)

**100** Staf i bashkive i trajnuar

**8** Numri i organizatave/ institucioneve vendore/ kombëtare të përfshira

**1**
- projektit termoizolues në Mirditë
- sistem ngrohje termike në Junik
- bazë të dhënash për Efiçiencën e Energjisë

**2** Numri i Planeve Vendore të Efiçiencës së Energjisë të hartuara

**4** trajnime për deri në 100 punonjës

**10** Objekte publike janë vlerësuar dhe audituar si në Mirditë ashtu edhe në Junik duke përfshirë masat specifike për efiçiencën e energjisë

**10** Numri i ndërtesave publike në të cilat është përfshirë shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë (panele fotovoltaike)

**13,000**
Popullsia e arritur nga fushata ndërgjegjësuese

Funded by
the European Union

# PËRFITIMET E PANELEVE FOTOVOLTAIKE

## KURSIME

Eliminon kostot e faturave të energjisë elektrike në disa ndërtesa dhe ul konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike në bashki deri në 70%

## ENERGJI FALAS

Energjia diellore është falas dhe e pashtershme



## PËRFITIMET MJEDISORE

Redukton emertimet e karbonit dhe lufton ndryshimet klimatike

## JETËGJATËSI

Sistemet fotovoltaike kanë një jetëgjatësi prej 25 vitesh

## MBROJTJE EKONOMIKE

Kundër rritjes së kostos së energjisë elektrike (pavarësi nga vlerat e tregut të energjisë elektrike)

## PRODHIMI NË DITË ME RE

Panelet vazhdojnë të prodhojnë energji elektrike edhe në ditë me re

## SISTEMI EFIÇENT I NGROHJES QËNDRORE

- Përmirëson komfortin termik në ndërtesë
- Redukton kostot dhe shpenzimet e ngrohjes
- Redukton emetimet e gazit në atmosferë

## IZOLIMI TERMIK

- Redukton emetimet,
- Redukton kërkesën për ngrohje/ftohje,
- Rrit komfortin termik dhe kushtet e jetesës
- Rrit jetëgjatësinë e ndërtesës,
- Redukton kostot e energjisë dhe rrit të ardhurat e bashkisë
- Rrit performancën e personelit/ personave që ushtrojnë aktivitet në godinë